# KËRKESË PËR RISHQYRTIM

*Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092*

Për: **KOMUNA E MAMUSHËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

| | |
|---|---|
| **Nr i Prokurimit** | **626-21-10608-1-1-1** |
| **Nr i brendshëm** | **626-21-027-1-1-1** |

Sa i përket tenderit për

**FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË**

## 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

MADEKOS SH.P.K.

*(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)*

**Vragoli, Vragoli, Fushë Kosovë, Kosovë, 846**

*(Adresa)*

**Fushë Kosovë**

**12 000**

*(Vendi)* *(Kodi postar)*

**+38344506414**

*(Numri Telefonit)* *(Numri i Faks-it)*

**Bedri Buzuku**

*(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)*

**made-kos@hotmail.com**

*(Adresa elektronike)*

MADEKOS SH.P.K. 4 MADEKOS 811560293 FUSHË KOSOVË

**03.03.2022**

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 2. Identifikimi i avokatit

*Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.*

*Shëno të dhënat si në vijim:*

__________________________________________________________

*(Emri i avokatit)*

__________________________________________________________

*(Adresa e plotë)*

____________________________

____________________________

*(Numri i Telefonit)* *(Numri i faks-it)*

____________________________

*(Adresa elektronike)*

____________________________

____________________________

*(Data e parashtrimit të kërkesës)* *(Nënshkrimi dhe vula)*

## 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

*[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:*

1. *Njoftimi per kontrate: 30.12.2021.*
2. *Procesverbali i hapjes: 08.02.2022.*
3. *Njoftimi mbi Vendimin e AK-se: 28.02.2022.*
4. *Kërkesa për qasje : 01.03.2022*
5. *Qasja në dokumenta zyrtare: 02.03.2022*

## 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

*A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.*

**Po** ☐ **Jo** ☒

Procesverbali i hapjes eshte pranuar permes platformes se e-prokurimit

5. **Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve,** *nëse aplikohet*

*A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?*

**Po** [x] **Jo** [ ]

6. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

*Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.*

**Shkeljet e LPP-se nga ana e AK-së:**

| | |
|---|---|
| **Neni 1** | Qëllimi |
| **Neni 6** | Ekonomiciteti dhe Efikasiteti |
| **Neni 7** | Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi |
| **Neni 56** | Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave |
| **Neni 59** | Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve |
| **Neni 60** | Kriteret për Dhënien e Kontratës |
| **Neni 65** | Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve |
| **Neni 66** | Përshtatshmëria Profesionale |
| **Neni 69** | Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale |

7. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

*Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.*

Të pakënaqur në Njoftimin e datës 28/02/2022 mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me aktivitetin e prokurimit **FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË,** me nr te prokurimit **626-21-10608-1-1-1** dhe nr te brendeshem: **626-21-027-1-1-1** ne afatin ligjor konform nenit 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, ushtrojme këtë:

**KËRKESË PËR RISHQYRTIM**

Për shkak se **AK- KUVENDI KOMUNAL MAMUSHË** :

- Na ka eliminuar ne menyre te kunderligjeshme nga ky aktivitet i prokurimit per kerkesa te cilat nuk i ka vendosur ne Njoftimin per Kontratë (NJK) dhe ne Dosje te tenderit (DT)..

**Sqarojmë ne mënyre te detajuar pretendimin tonë:**

Autoriteti Kontraktues KK Mamushë me date 28.02.2022 (ndersa ne njoftim AK e ka vendosur daten 28.02.2028 ) nepermjet E-prokurimit e ka publikuar njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me te cilin njoftim na ka eliminuar nga aktiviteti i prokurimit **FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË,** me nr te prokurimit **626-21-10608-1-1-1** dhe nr te brendeshem: **626-21-027-1-1-1** me arsyen e vetme se "paskam bere nje leshim" si me poshtë:

ARSYETIM

**Tenderi juaj është refuzuar për arsye si vijon:**

Komisioni vlerësues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit tuaj, ka konstatuar se ju ne tenderin tuaj nuk keni dorëzuar Afatin e liferimit. Në nenin 5.5 të Dosjes së Tenderit në Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) është kërkuar që:
-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin e liferimit.
-Afati i liferimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 (Pesë) ditë nga data e porosisë.
Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do ti refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.

*Lëshimi i cekur më lart ka bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.*

Autoriteti Kontraktues me kete veprim te eliminimit tone, pa te drejte dhe ne kundershtim me dispozitat e LPP-se dhe RrUOPP-së e rekomandon per kontrate nje operator ekonomik tjeter gati me çmim dyfish me te shtrejte se oferta e jone duke vepruar ne kundershtim me nenin 59 te LPP-se Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve me konkretisht ne piken 4 te ketij neni thuhet:

*Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.*

Pra siç po shihet me larte per tu konsideruar nje tender i pergjegjeshem duhet ti plotesoj kerkesat e AK-se te vendosura ne NJK dhe DT pra siç po shihet NJK dhe DT po shkojn e se bashku atehere AK kerkesen per te cilen na ka eliminuar nuk e ka vendosur ne NJk e as ne DT nese i shiqojme te gjitha kerkesat e vendosura nga AK ne NJK dhe DT askund nuk mund ta gjejme piken per te cilen jemi eliminuar pra nese e shikojmë NJK dhe DT:

-Te Kërkesat e përshtatshmërisë nuk eshte ajo kerkese,

- Te Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale nuk eshte ajo kerkese,

- te Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare nuk eshte ajo kerkese,

-te Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nuk eshte ajo kerkese,

Pra siç shihet me larte AK nuk e ka vendosur nje kerkese te tille as ne NJK dhe as ne DT, edhe sikur ta vendoste nje kerkese te tille psh vetem ne NJK e jo ne DT nuk ka te drejte ta eliminoj asnje OE pasi qe ligji e percakton qarte se kerkesa duhet te jete e vendosur ne NJK dhe DT per me detajisht dhe duke pasur parasysh që nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, atehere i bejme me dije AK-se se, asnjë operator ekonomik nuk mund të eliminohet për ndonjë kërkesë që nuk është e vendosur në dosje të tenderit dhe tek njoftimi për kontratë ashtu siç parashihet tek neni 56 paragrafi 3 i LPP-së ku shkruan se: *"Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*. Pra AK e ka eliminuar OE-Madekos sh.p.k. per nje kerkese apo kriter qe nuk ka qene e vendosur ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit per tu plotesuar nga Operatoret ekonomik pra afati i liferimit nuk ka qene kerkese per vleresim.

Sa per dijenin e AK-se ju njoftojme se OSHP ka nxjerr vendime ku, ju ka dhene te drejte OE-ve gjithmone, kur AK nuk e kane parapare afatin e liferimit tek kerkesat per vleresim siç janë: keresat e pershtatshmerise, pershtatshmerise profesionale, kerkesat mbi gjendjen ekonomike financiare apo edhe tek kerkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pasi qe tek keto keresa ne anen tjeter te tabeles jane te shenuara edhe deshmite me te cilat duhet te plotesohen keto keresa. Sa per ilustrim keni vendimet: PSH 236/16, PSH 376/17, PSH 11/18 dhe UZV 180/18, PSH 110-119-121/21 si dhe vendime te tjera.

Neve si OE e kemi nenshkruar deklaraten e tenderit dhe pajtohmi plotesisht me te gjitha kushtet e tenderit ne fjale gjithashtu i kemi nenshkruar edhe deklaratat dhe anekset tjera andaj eliminimi jone per nje kerese qe nuk ka qene kerese e vleresimit eshte i pa pranueshem.

Krejt ne fund

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë. Gjithashtu autoriteti

kontraktues nuk ka vepruar ne harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së.

Autoriteti kontraktues në këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka pasur në konsideratë edhe Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi ku Qellimi i ketij neni eshte qe Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Autoriteti kontraktues ne kete aktivitet te prokurimit, ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve nuk e ka bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët, ku AK ka vepruar ne kundershtim me nenin 60 të LPP-së.

Besojme se i kemi elaboruar me shume se sa qe duhet shkeljet e AK-se ne kete aktivitet te Prokurimit andaj, Kerkojm nga AK qe ti rrespektoj ne perpikeri dispozitat e ligjit te prokurimit publik gjithashtu ti rrespektoj keresat e veta te cilat vet i ka vendosur ne njoftimin per kontrate dhe ne dosje te tenderit dhe te nxjerr;

## V E N D I M

**I. APROVOHET,** si e bazuar kerkesa per rishqyrtim e operatorit ekonomik MADEKOS SH.P.K. Lidhur me aktivitetin e prokurimit FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË, me nr te prokurimit 626-21-10608-1-1-1 dhe nr te brendeshem: 626-21-027-1-1-1. Te inicuar nga Autoriteti Kontraktues KK Mamushë.

**II. ANULOHET,** njoftimi per dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË, me nr te prokurimit 626-21-10608-1-1-1 dhe nr te brendeshem: 626-21-027-1-1-1. Te inicuar nga Autoriteti Kontraktues KK Mamushë dhe lënda kthehet ne **Rivleresim.**

Pas rivleresimit AK - KK Mamushë ta shpall OE-në MADEKOS SH.P.K. fitues te ketij tenderi.

**8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

**Shpenzimet mbi angazhimi ne pergaditjen e ofertave, sigurimin e ofertes, shpenzimet per sherbime te avokatise dhe fitimin e humbur.**

**9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

*a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
*b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
*c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
*d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

# PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

| | | | |
|---|---|---|---|
| Numri i prokurimit<br>Procurement number<br>Broj nabavke: | 626-21-10608-1-1-1 | Titulli i Kontratës<br>Contract Title<br>Naslov ugovoru | FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË |
| Numri i brendshëm<br>Internal No<br>Interni broj | 626-21-027-1-1-1 | | |

| Data e lëshimit<br>Date of issue<br>Datum izdavanja | Data e mbyljes<br>Closing date<br>Datum zatvaranja & Čas | Data e hapjes & Ora<br>Opening date & time<br>Datum Otvaranja & Čas | Vendi<br>Place<br>Mesto | Nr. i tenderëve të pranuar<br>No. of Received Tenders<br>Br. Primljenih Tendera |
|---|---|---|---|---|
| 08.02.2022 | 08.02.2022, 13:30:00 | 08.02.2022, 13:30:00 | Objekti i Komunës së Mamushës-Zyra e prokurimit nr. 17 | 4 |

| Nr.<br>Br. | Tenderuesi<br>Tenderer<br>Tenderer | Kodi i tenderit<br>Tender label /code<br>Oznaka ponude | Pjesë<br>Lot<br>Lot | e-tenderit<br>e-tender<br>e-ponuda | Çmimi<br>Price<br>Cena<br>€ | Çmimi (me TVSh)<br>Price (with VAT)<br>Cena (sa PDV)<br>€ | Ndryshimi/plotësimi<br>Suplement/Amendment<br>Dpuna/Izmjena |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Grup i Operatorëve Ekonomik MEDPLUS SH.P.K.; KEIS(KOSOVA EX.IMP.SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K., Rr. Pranvera e Lirisë, 10000, Prishtinë | 01-01/2022 | FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË | PO | 38,45 | 41,32 | JO |
| 2. | MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, -, PRISHTINË | MATKOS PHARM | FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË | PO | 128,39 | 138,67 | JO |
| 3. | MADEKOS SH.P.K., Vragoli ( Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë | 626-21-10608-111 | FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË | PO | 24,51 | 26,47 | JO |
| 4. | Shefqet Mehmetukaj B.I., Magjistr. Prishtinë-Shkup, 10000, LLAPNASELLË | 202202080001 | FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-N NË MAMUSHË | PO | 62,31 | 67,30 | JO |

**Komente nga përfaqësuesit e pranishem**
**Comments from the present authorized representatives of the CA and the EO at the opening of tenders:**
**Komentari prisutnih ovlaštenih predstavnika UA i EO na postupak otvaranja ponuda**

Nuk ka

**Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO**

| Nr.<br>Br | Tenderuesi, Emri / Mbiemri<br>Tenderer, Name / Surname<br>Tenderer, Ime / Prezime | Nënshkrimi<br>Signature<br>Potpis |
|---|---|---|
| | N/A | |
| | | |

**Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja**

| Emri Mbiemri<br>Name Surname<br>Ime Prezime | Nënshkrimi/ Signature/ Potpis | Datë/ Date/ Datum |
|---|---|---|
| Gazmend Gashi | | |
| Derya Kala | [signature] | 08. 02. 2022 |
| Mehmet Morina | [signature] | 08. 02. 2022 |
| Aziz Elshani | | |
| | | |

**Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:**

**Mehmet Morina**

[signature]

* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŞA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA

# B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

*Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik*

**Titulli i kontratës:"FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-n NË MAMUSHË"**
**Numri i aktivitetit te prokurimit:**

| | |
|---|---|
| Nr i prokurimit | 626-21-10608-1-1-1 |
| Nr i brendshëm | 626-21-027-1-1-1 |

| Nr. | Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës | Vlera totale e ofertave sipas Poentimit |
|---|---|---|
| 1. | "Grup i Operatorëve Ekonomik MEDPLUS SH.P.K.; KEIS(KOSOVA EX.IMP.SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K., Rr. Pranvera e Lirisë, 10000, Prishtinë | 41,32 € |
| 2. | MATKOS PHARM SH .P.K., SHPETIM ROBAJ NR. 289, -, PRISHTINË | 53,14 € |
| 3. | MADEKOS SH.P.K., Vragoli ( Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë | 26,47 € |
| 4. | Shefqet Mehmetukaj B.I., Magjistr. Prishtinë-Shkup, 10000, LLAPNASELLË | 67,30 € |

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

***Komuna e Mamushës-Zyra e Prokurimit*** **shpërblen** me kontratë **Grupin e Operatorëve Ekonomik** të përgjegjshëm " **MEDPLUS SH.P.K.; KEIS(KOSOVA EX.IMP.SUPPLY PHARMACEUT) SH.P.K."** në Vlerë totale të ofertës sipas Poentimit prej **41,32 €.**

Data: **28.02.2028**

Emri dhe mbiemri i ZPP: **Gazmend Gashi**
Nënshkrimi: ____________

**Këshillë juridike: Çdo palë e interesuar e cila mendon se të drejtat e tij/saj janë shkelur nga vendimi i autoritetit kontraktues gjatë kryerjes së këtij aktiviteti të prokurimit, mund të bëjë kërkesë për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 ne adresën e Autoritetit Kontraktues, përmes platformës elektronike.**

[1]Ketijformulariibashkangjitenedheletratstandardetenjoftimeve: B42, B45 dhe B46.( shtoniletranjoftuesesipasnevojes).

Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa

# Letër standarde për tenderuesin e eliminuar [3]

Mamushë më: 28.02.2022

Komuna e Mamushës- Zyra e Prokurimit

Për: Operatorin Ekonomik:" MADEKOS SH.P.K. Vragoli ( Magjistralja Prishtinë-Pejë), 12000, Fushë Kosovë

| | |
|---|---|
| Nr i prokurimit | 626-21-10608-1-1-1 |
| Nr i brendshëm | 626-21-027-1-1-1 |

Titulli:" FURNIZIMI ME BARËRA PËR QMF-n NË MAMUSHË"

I nderuar Z. Bedri Buzuku

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kritereve të dhëna në Njoftimin për Kontratë dhe ne Dosjen e Tenderit.Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

☐ Certifikatat apo dëshmitë e kërkuara te cilat tregojnë apo pohojnë se nuk jeni i diskualifikuar nga ndonjë masë nën Nenin 65 të LPP;

☐ Certifikatën, dokumentin ose ndonjë dëshmi tjetër të mjaftueshme te kërkuar sipas Nenit 66 të LPP për të dëshmuar përshtatshmërinë profesionale tuaj;

☐ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 68 dhe 69 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbushni kërkesat minimale të gjendjes ekonomike dhe financiare dhe te kapacitetit teknik/profesional të saktësuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës.

*Tenderi i juaj* është administrativisht i papërgjegjshëm:

☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e sigurisë së tenderit;
☐ Nuk e keni plotësuar dhe nënshkruar si duhet *[Formularin e paraqitjes së tenderit] [Formularin e paraqitjes së aplikacionit];*
☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat e vlefshmërisë së tenderit;
☐ Nuk i keni paraqitur numrin e mjaftueshëm të kopjeve të kërkuara;
☐ Nuk e keni paraqitur deklaratën e cila identifikon nënkontraktuesit e zgjedhur për aktivitetin relevant te prokurimit;
☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat fomale/administrative
☒ **(Afatin e liferimit) nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 (Pesë) ditë**.

[3] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt .*

☐ Nuk i keni përmbushur kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

☐ *Nëse është e zbatueshme, kërkesa tjera formale/administrative.*
*[Në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik]-N/A*
☐ Nën-kontraktuesi (t) juaj nuk i ka përmbushur kërkesat e përshtatshmërisë.

*[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje]* është i papërgjegjshëm sepse nuk keni dorëzuar:

ARSYETIM

**Tenderi juaj është refuzuar për arsye si vijon:**

**Komisioni vlerësues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit tuaj, ka konstatuar se ju ne tenderin tuaj nuk keni dorëzuar Afatin e liferimit. Në nenin 5.5 të Dosjes së Tenderit në Seksioni II. FLETA E TË DHENAVE TË TENDERIT (FTD) është kërkuar që:**
**-Operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë tender janë të obliguar që të hartojnë afatin e liferimit.**
**-Afati i liferimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 (Pesë) ditë nga data e porosisë.**
**Në rast të mos përmbushjes së këtij kushti O.E. do të konsiderohet si i pa përgjegjshëm, oferta do ti refuzohet dhe do të qojë në eliminimin e operatorit ekonomik.**

***Lëshimi i cekur më lart ka bërë që ju të eliminoheni nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në tenderin në fjalë.***

Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur LPP apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë te parashtroni ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Edhe nëse nuk kemi qene në gjendje t`i përdorim shërbimet tuaja kësaj here, besojmë se do të vazhdoni të shfaqni interesim për nismat tona të ardhshme të prokurimit.

Me respekt,

**Gazmend Gashi**
*(Emri dhe Mbiemri i Zyrtarit të Prokurimit)*

*(Nënshkrimi)*